



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCËVE  
DHE EKONOMISË

## **FTESË PËR OFERTË**

Për Këshilltarin Ligjor për emetimin e mundshëm të Eurobondit

30 Nëntor, 2022

---

## **Kontakt**

Ministrisë së Financave dhe  
Ekonomisë së Shqipërisë  
Bulevardi “Dëshmorët e  
Kombit” , Nr. 3; Tiranë,  
Shqipëri

Në vëmendje të:

**Mrs. Belina Memeti**

Drejtor

Drejtorja e Huamarrjes

[Belina.Memeti@financa.gov.al](mailto:Belina.Memeti@financa.gov.al)

Çdo pyetje në lidhje me “Ftesën për Ofertë” duhet të adresohet pranë Znj. Belina Memeti

---

## Ftesë për ofertë\*

Jeni të lutur të paraqisni një propozim me shkrim për të vepruar si Këshilltar Ligjor në emetimin e mundshëm të një Eurobondi nga Republika e Shqipërisë dhe parablerje (buyback) të eurobondit ekzistues i cili maturohet në vitin 2025.

### I. Konteksti dhe Objektivat

Pas emetimit me sukses të Eurobondit në vitin 2021, me vlerë 650 milion €, me maturitet 10 vite dhe me një normë kuponi prej 3.50%, Republika e Shqipërisë ("Republika", ose Emetuesi"), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, synon: (i) të emetojë një Eurobond në muajt ne vijim, në tregjet ndërkombëtare të kapitalit, dhe (ii) parablerjen e mundshme të eurobondit ekzistues i cili maturohet në vitin 2025 (buyback) më metodën e Tender Offer . Si rrjedhojë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, kërkon të sigurojë shërbimin e një firme ligjore të specializuar në dhënien e konsulencës ligjore për emetimin e Eurobondit të gjashtë, me ekspertizë në ligjin anglez dhe ligjin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për letrat me vlerë.

### II. Qëllimi dhe Objekti i Shërbimit

#### i. Qëllimi i Shërbimit

Sigurimi i shërbimit sa më të mirë në dobi të interesave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si përfaqësuese e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, gjatë periudhës së emetimit të një Eurobondi me metodën RegS/144A, si edhe gjatë gjithë procesit të parablerjes "buyback" të eurobondit, në mënyrë të tillë që në asnjë moment këto interesa të mos çenohen, si rezultat i këtij transaksioni. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës është e detajuar si më poshtë:

- Fondi Limit/vlera e pritshme për emetimin e eurobondit të ri është: 21,857,800.00 Lekë, pa TVSH
- Fondi Limit për parablerjen e mundshme të Eurobondit ekzistues, me metodën Tender Offer" është: 5,500,985.71 Lekë, pa TVSH
- **Total Fondi Limit: 27,358,785,71 Lekë, pa TVSH**

#### ii. Objekti i Shërbimit

**A. Rishikimi i çështjeve ligjore dhe rregullatore** - Këshillimi mbi ligjin e bursës si edhe mbi rregullore të tjera të zbatueshme lokale dhe tatimore (në bashkëpunim me këshillues vendas), mbi çështjet e emetimeve ndërkombëtare të bondeve nga entitete sovraane si edhe mbi parablerjen e Eurobondit ekzistues.

- Këshillim dhe asistencë në çështjet e mëposhtme:

---

\* Kjo ftesë për ofertë, lëshuar nga Republika e Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, duke vepruar mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.311, datë 27.05.2021, është për përdorimin ekskluziv të personave të cilëve u adresohet në lidhje me Ofertën (siç përcaktohet këtu).

- 
- Asistencë në strukturimin e ofertës duke përfshirë (i) emetimin e një bondi në shumë tregje, i cili synon të tërheqë investitorë të rëndësishëm në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Europë apo apo diku tjetër, (ii) si edhe asistencë në parablerjen të Eurobondit ekzistues me metodën Tender Offer.
  - Asistencë në ndikimin që mund të kenë rregulloret ndërkombëtare për emetimin e letrave me vlerë në përgjithësi në këtë emetim, si edhe ndikimi që ka Ligji Amerikan dhe European në veçanti.
  - Çështje të tjera ligjore që kanë të bëjnë me ofertën, siç janë detyrimet fiskale që lidhen me ofertën.
  - Procedurat lidhur me listimin në bursë.
  - Çështjet ligjore dhe praktike të tregut lidhur me ofertat e bondeve qeveritare, duke përfshirë qëllimin e informacionit të kërkuar në prospektus, emetimin dhe procedurën e shlyerjes, heqjen dorë nga imunitetet sovraane, zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm dhe klauzolave të veprimit kolektiv.
- Konsultimi dhe bashkëpunimi me shërbimet ligjore shtetërore dhe këshilltarët ligjorë të bankave që veprojnë si menaxhere-udhëheqëse (Joint Lead Managers) mbi aspektet ligjore, rregullatore, tatimore dhe aspekte të tjera relevante të ligjit të vendit.
  - Asistimi i vendit, në përzgjedhjen e anëtarëve të tjerë të procesit, nëse konsiderohet e nevojshme.

**B. Asistencë gjatë procesit të Due Diligence** - Këshillim dhe asistencë gjatë procesit Due Diligence, i cili konsiston në verifikimin e saktësisë së informacionit të përfshirë në dokumentet e ofertës.

- Shpjegimi i qëllimit dhe natyrës së procesit Due Diligence në lidhje me përgatitjen e dokumentacionit të ofertës (duke përfshirë letrën 10b-5 në rast të ofrimit me Rregullin 144A).
- Ofrimi i asistencës në përpunimin e informacionit ose kërkesave për intervista me përfaqësues të qeverisë nga bankat të cilat veprojnë si menaxhere-udhëheqëse (Joint Lead Managers) dhe këshilltarëve të tyre ligjorë.
- Marrja pjesë në takimet e auditimit paraprak me zyrtarët shtetërorë, me bankat që veprojnë si menaxhere-udhëheqëse (Joint Lead Managers) si edhe me këshilltarët e tyre ligjorë.

**C. Përcaktimi i afateve kohore**

- Konsultimet me Republikën e Shqipërisë, dhe me bankat që veprojnë si menaxhere-udhëheqëse (Joint Lead Manager) në përcaktimin e kohës së transaksionit, duke marrë parasysh kushtet e tregjeve ndërkombëtare të kapitalit dhe strukturën e emetimit dhe strukturën e parablerjes (buyback) me metodën Tender Offer.
- Bashkëpunimi me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, dhe palë të tjera të përfshira në këtë proces për t'u siguruar që procesi është duke u zhvilluar në përputhje me skedulën e parashikuar.

---

#### **D. Përgatitja e dokumentacionit të ofertave për transaksionin e Eurobondit**

- Udhëheq në hartimin e një prospektusi lidhur me transaksionin, përfshirë informacionin përshkrues të vendit, në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe praktikën e tregut për emetimet e bondeve qeveritare. Ndjekjen e seancave të draftimit të dokumentit si edhe përgatitja e draft prospektusit të rishikuar.
- Rishikimin dhe negocimin në emër të Republikës së Shqipërisë të termave të “letrës së mandatimit” me bankat menaxhere-udhëheqëse (Joint Lead Manager).
- Rishikimin dhe negocimin në emër të Republikës së Shqipërisë, të kushteve të Marrëveshjes së Abonimit (Subscription Agreement) me bankat që veprojnë si menaxhere-udhëheqëse (Joint Lead Managers) dhe këshilltarët e tyre.
- Negocimi në emër të Republikës së Shqipërisë me bankat që veprojnë si udhëheqëse-menaxhere (Joint Lead Managers), me agjentin fiskal dhe me të besuarin (trustee), sipas rastit, dhe me këshilltarët e tyre, i draftit të Marrëveshjes së Agjencisë (Fiscal Agency Agreement) ose Marrëveshjes së Besimit (Act Trust Deed), sipas rastit.
- Negocimi me bankat që veprojnë si udhëheqëse-menaxhere (Joint Lead Managers), dhe me këshilltarët e tyre, i termave të opinionit ligjor dhe opinionit negativ (negative clearances), përputhshmërinë me kufizimet e shitjes në Amerikë dhe në Europë si edhe çështje të tjera të rëndësishme për këtë proces.
- Bashkëpunimi me shërbimet ligjore qeveritare për të përgatitur dokumentacionin qeveritar të kërkuar për këtë proces, si edhe opinionit ligjor për t’u lëshuar nga autoritetet përkatëse shtetërore.

#### **E. Përfundimi i dokumentacionit**

- Përfundimi i prospektusit fillestar dhe monitorimi i printimit të tij; përfundimi i prospektusit final dhe monitorimi i printimit të tij. Asistimi i vendit në negocimin përfundimtar të Marrëveshjes së Agjencisë (Fiscal Agency Agreement) ose të Marrëveshjes së Besimit (Trust Deed), sipas rastit, dhe të Marrëveshjes së Abonimit (Subscription Agreement).
- Përfundimi i dokumentacionit të ofertës për qëllime të kërkesave të listimit, nëse do të aplikohet.

#### **F. Hedhja e bondeve në treg, mbyllja e ofertës së transaksionit të Eurobondit dhe listimi në bursë**

- Asistimi i përfaqësuesve të shtetit si edhe bankave që veprojnë si udhëheqëse-menaxhere (Joint Lead Managers) në çështjet ligjore gjatë përgatitjes për procesin e Road Show.
- Koordinimi me bankat që veprojnë si udhëheqëse-menaxhere (Joint Lead Managers) si edhe asistimi i vendit gjatë procesit të Due Diligence, e cila do t’i paraprijë listimit dhe mbylljes së ofertave.
- Koordinimi i nënshkrimit të dokumentacionit si edhe mbylljes së procesit të dhënies së ofertave në emër të vendit.

- Pjesëmarrja në përgatitjen e kërkesave të listimit si edhe përgjigjet për informacionin e kërkuar nga bursat përkatëse.
- Koordinimi i listimit të bondeve me agjentin listues dhe këshilltarin ligjor ndërkombëtar të bankave të cilat veprojnë si udhëheqëse-menaxhere (Joint Lead Manager).
- Asistimi i vendit, sipas kërkesës, në të gjitha çështjet pas procesit të përfundimit, duke përfshirë përgatitjen e një memorandumit mbi detyrimin e raportimit të vendit, të Marrëveshjes së Agjencisë (Fiscal Agency Agreement) dhe/ose të Marrëveshjes së Besimit (Trust Deed), sipas rastit, dhe sipas kushteve të pranimit në bursë, nëse kërkohet.

### **III. Vendi dhe Frekuenca e kryerjes së Shërbimeve**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, konkretisht Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj, dhe kudo tjetër ku është e nevojshme, kurdoherë dhe aq shpesh sa Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka nevojë për ndihmën e këshilltar ligjor në lidhje me të gjithë emetimin e Eurobondit.

### **IV. Kriteret e pranimit/kualifikimit**

- **Zarfi A duhet të përmbajë dokumentet e listuara më poshtë:**

#### **A. Kriteret e përgjithshme kualifikuese**

Paraqitja e vetedeklaratave me shkrim nga kompania që:

- a) është i regjistruar në autoritetet përkatëse të vendit të origjinës dhe ka në fushën e veprimtarisë shërbimin e konsulencës;
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv);
- c) nuk është dënuar për shkelje penale;
- d) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
- e) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) të paraqesë deklaratën mbi Konfliktin e Interesit;
- g) të paraqesë deklaratën mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit.

#### **B. Oferta teknike**

- 1. Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë** - Ekstrakt historik i regjistrit tregtar ose dokumentin ekuivalent të leshuar në vendin e origjinës për rastin e subjekteve të huaja ku periudha e veprimtarisë së operatorit ekonomik duhet të rezultojë jo më pak se 7 vjet eksperience aktive në fushën shërbime konsulente.
- 2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**
  - a) Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit 2019 -2020-2021 të konfirmuara në autoritetet përkatëse.

---

b) Operatori ekonomik duhet të dëshmojë, përvojën në kryerjen e shërbimeve të mëparshme të ngjashme me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që do të lidhet, të realizuar gjatë tre viteve të fundit me institucione shtetërore.

3. **Kapaciteti teknik** - Licensë profesionale të subjektit dhe të ekspertëve të kontraktuar prej saj, të lëshuar nga institucioni shtetëror i ngarkuar për dhënien e licensave profesionale sipas dispozitave në fuqi të lëshuar në vendin e origjinës.

4. **Cv e operatorit ekonomik** - një përshkrim i përgjithshëm i profilit të veprimtarisë, të dhëna të përgjithshme lidhur me eksperiencën dhe bashkëpunime në përmbushje të projekteve të ndryshme me natyrë konsulencë në fushën e shërbimeve të konsulencës ligjore (Profili i kompanisë kërkohet, i prezantuar edhe nga prospekti i tij zyrtar (faqe interneti, katalog, etj.).

**6- Operatorët Ekonomike duhet të paraqesin:** perberjen e ekipit të cilet do të angazhohen në këto shërbime, shoqeruar me diplomat përfaqësues kualifikimet, specializimet, Cv e tyre, licensat/certificate profesionale kur kanë të tilla. Kompania konsulente duhet të sigurojë 5 ekspertë, ku 1 (një) ekspert kryesor (lider), 2 (dy) ekspertë Senior dhe 2 ekspertë mbështetës, që të plotësojnë kriteret profesionale/akademike të mëposhtme:

**a) Lideri i ekipit**

**Kualifikimet dhe aftësitë:**

- i. Të jetë i diplomuar në Shkencat Juridike;
- ii. Njohuri të thelluara mbi Këshill
- iii.
- iv. limin mbi ligjin e bursës si edhe mbi rregullore të tjera, mbi çështjet e emetimeve ndërkombëtare të bondeve nga entitete sovraane;
- v. Njohuri të thelluara mbi dhënien e asistencës/këshillimit gjatë procesit Due Diligence;
- vi. Të ketë përvojë në dhënien e asistencës mbi emetimin e një bondi në shumë tregje (Amerikë, Europë apo diku tjetër);
- vii. Të paktën 7 vjet përvojë praktike/konsulencë në fushën e konsulencës ligjore dedikuar për këtë shërbim;
- viii. Përvojë pune në menaxhim, aftësi këshilluese dhe operacionale me struktura qeveritare.

*\*Kërkesat nga pika (i) deri në (vi) të jenë të provuara me dëshmi kualifikimi/specializimi, licensa/certificata profesionale/ letër referenca që vërtetojnë përmbushjen e këtyre pikave.*

**b) Ekspert nr. 1**

**Kualifikimet dhe aftësitë**

- i. Të jetë i diplomuar në Shkencat Juridike;

- 
- ii. Njohuri të thelluara mbi Këshillimin mbi ligjin e bursës si edhe mbi rregullore të tjera të zbatueshme mbi çështjet e emetimeve ndërkombëtare të bondeve nga entitete sovraane;
  - iii. Të ketë përvojë në dhënien e asistencës mbi emetimin e një bondi në shumë tregje (Amerikë, Europë apo diku tjetër);
  - iv. Të paktën 5 vjet përvojë praktike/konsulence në fushen e konsulencës ligjore të dedikuar për këtë shërbim;
  - v. Rezultate të provuara për asistencën e dhënë;
  - vi. Përvojë pune në menaxhim, aftësi këshilluese dhe operacionale me struktura qeveritare.

*\*Kërkesat nga pika (i) deri në (vi) të jenë të provuara me dëshmi kualifikimi/specializimi, licensa/certificata profesionale/ letër referenca që vertetojnë përmbushjen e këtyre pikave.*

#### **c) Ekspert nr. 2**

##### **Kualifikimet dhe aftësitë**

- i. Të jetë i diplomuar në Shkencat Juridike dhe ose Ekonomike.
- ii. Njohuri të thelluara mbi çështjet ligjore dhe praktike të tregut lidhur me ofertat e bondeve qeveritare, duke përfshirë qëllimin e informacionit të kërkuar në prospektus, emetimin dhe procedurën e shlyerjes, heqjen dorë nga imunitetet sovraane, zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm dhe klauzolave të veprimit kolektiv.
- iii. Të paktën 5 vjet përvojë praktike/konsulence në fushen e konsulencës ligjore;
- iv. Rezultate të provuara për asistencën e dhënë në fushen e konsulencës ligjore të dedikuar për këtë shërbim;
- v. Përvojë pune në menaxhim, aftësi këshilluese dhe operacionale me struktura qeveritare.

*\*Kërkesat nga pika (i) deri në (v) të jenë të provuara me dëshmi kualifikimi/specializimi, licensa/certificata profesionale/ letër referenca që vertetojnë përmbushjen e këtyre pikave.*

#### **d) Ekspert mbështetës nr. 3**

##### **Kualifikimet dhe aftësitë**

- i. Të jetë i diplomuar në Shkencat Juridike dhe ose Ekonomike.
- ii. Të paktën 5 vjet përvojë praktike/konsulence në fushën e konsulencës ligjore të dedikuar për këtë shërbim.
- iii. Përvojë dhe aftësi këshilluese dhe operacionale në projekte të ngjashme konsulence;

*\*Kërkesat nga pika (i) deri në (iii) të jenë të provuara me dëshmi kualifikimi/specializimi, licensa/certificata profesionale/ letër referenca që vertetojnë përmbushjen e këtyre pikave.*

#### **e) Ekspert mbështetës nr. 4**

##### **Kualifikimet dhe aftësitë**

- 1. Të jetë i diplomuar në Shkencat Juridike dhe ose Ekonomike.
- 2. Të paktën 3 vjet eksperiencë të gjerë dhe përvojë praktike në konsulencë të dedikuar për këtë shërbim;.

3. Përvojë dhe aftësi këshilluese dhe operacionale në projekte të ngjashme konsulence të dedikuar për këtë shërbim;

*\*Kërkesat nga pika (i) deri në (iii) të jenë të provuara me dëshmi kualifikimi/specializimi, licensa/certificata profesionale/ letër referenca që vertetojnë përmbushjen e këtyre pikave.*

- **Zarfi B duhet të përmbajë Propozimi ekonomik duke ju referuar modelit të mëposhtëm:**

Kandidati duhet të paraqesë:

Dispozitat e shërbimeve ligjore në lidhje me përgatitjen dhe emetimin e bondeve sovrane të denominuar në Euro në përputhje me formatin Reg S dhe 144A nën Aktin e Letrave me Vlerë të SHBA të vitit 1993, **sipas kategorisë së punës:**

Përshkrimi	Euro	
	Në shifra (€)	Në fjalë (€)
Rishikimi i çështjeve ligjore dhe rregullatore		
Asistencë në procesin e due diligence		
Përkufizimi i një afati kohor për zbatim		
Përgatitja e dokumenteve të ofertës		
Përfundimi i dokumenteve të ofertës		
Bonds placement, mbyllja e ofertës dhe listimi i bursës		
Çdo punë tjetër të nevojshme për emetimin e intrumenteve ndërkombëtare të këtij lloji		
Tarifa e rimbursimit (nëse due diligence zhvillohet në Tiranë)		
Totali		

Kandidati duhet të paraqesë:

Dispozitat e shërbimeve ligjore në lidhje me parablerjen e Eurobondit ekzistues 2025 (Tender Offer) , **sipas kategorisë së punës:**

Përshkrimi	Euro	
	Në shifra (€)	Në fjalë (€)
Rishikimi i çështjeve ligjore dhe rregullatore		
Asistencë në procesin e due diligence		

Përkufizimi i një afati kohor për zbatim		
Përgatitja e dokumenteve në lidhje me parablerjen (Tender Offer)		
Përfundimi i dokumenteve të Tender Offer		
Çdo punë tjetër të nevojshme për Tender Offer		
Tarifa e rimbursimit (nëse due diligence zhvillohet në Tiranë)		
<b>Totali</b>		

## V. Kriteret e vlerësimit

### A. Vlerësimi i Propozimit Teknik

Vlerësimi i Propozimeve Teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

**Kriteret e Vlerësimit** **Pikët**  
**1. Përvoja për Punë të Ngjashme të Konsulentit** **[20 pikë]**

#### Nënkriteret

- a) Përvoja për punë të ngjashme [12 pikë]  
 Operatorët ekonomikë, të vlerësohen sipas kontratave të sukseshme të ngjashme me objektin e kontratës.
- b) Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë [8 pikë]  
 Operatorët ekonomikë të vlerësohen sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitur në ofertë.

**2. Metodologjia e Propozuar** **[30 pikë]**

#### Nënkriteret

- a) Përqasja teknike dhe metodologjia [ 8 pikë]
- b) Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit [10 pikë]
- c) Organizimi i Stafit [12 pikë]
- a) **Përqasja teknike dhe metodologjia:** Konsulenti duhet të paraqesë problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojë për zgjidhjen e tyre. Konsulenti duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adoptojë dhe të paraqesë kompatibilitetin e këtyre metodologjive me qasjen e propozuar (Konsulenti në këtë rast nuk duhet të përsërisë/ kopjojë termat e referencës).
- b) **Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit:** Konsulenti duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndër lidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe proj
- c) **ektit.** Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përqasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret.

- d) **Organizimi i Stafit:** Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin kryesor.

**3. Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar** [50 pikë]

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

- a) a- Kualifikim i përgjithshëm [10 pikë]  
b) b. Eksperienca në fushën përkatëse [40 pikë]
- a) Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencë.  
b) Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

**Pikët për Propozimin Teknik** **100 pikë**

**Shënim: Minimumi i pikëve të Propozimit Teknik, për të vazhduar me vlerësimin e propozimit ekonomik, është 70 pikë.**

**B. Vlerësimi i Propozimit Ekonomik**

Vlerësimi i Propozimeve Ekonomik kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Pe- Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç – Çmimi Ofertues i Radhës (*duke filluar nga çmimi më i ulët*)

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

**Pikët për Propozimin Ekonomik** **100 pikë**

**C. Vlerësimi përfundimtar**

Pikët për Propozimet Teknike dhe Financiare sipas peshave janë dhënë si më poshtë:

**Pikët totale për Propozimin Teknik: X = (pikët e propozimit teknik x 0.8)**

**Pikët totale për Propozimin Ekonomik: Y = (pikët e propozimit ekonomik x 0.2)**

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

$$\text{Oferta më e mirë} = X + Y$$

Operatori ekonomik që ka marrë më shumë pikë gjatë mbledhjes së pikëve teknike dhe ekonomike do të ftohet për negociata dhe lidhjen e kontratës.

**VI. Procesi i dorëzimit**

---

Zarfat e vulosur duhet të dorëzohen në protokollin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ku propozimet ndahen në dy zarfe të veçanta, të mbyllura dhe jotransparente, të quajtura:

- Zarfë A (Dokumentet e Propozimit Teknik)
- Zarfë B (Dokumentet e Propozimit Ekonomik)

Nënshkruar dhe me këto shënime:

- adresën;
- Shënimin: Zarfë A " Propozimi Teknik për Konsulencë Ligjore  
Zarfë B " Propozimi Ekonomik për Konsulencë Ligjore

- datën dhe orën e hapjes së zarfit;
- emrin e ofertuesit;

Të dy gjuhët Anglisht ose Shqip do të pranohen për Ofertën dhe të gjitha korrespondencat / dokumentet në lidhje me Ofertën dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Të dy zarfat (si origjinal ashtu edhe një kopje për secilin zarf), duhet të dërgohen në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë deri më 19 Dhjetor 2022, ora 10:00, me kohën e Tiranës. Ministria e Financave dhe Ekonomisë rezervon të drejtën të refuzojë çdo propozim që nuk është marrë deri në këtë kohë.

**Propozimet do të hapen nga komisioni i vlerësimit të ofertave më datë 19 Dhjetor 2022. ora 10:15.**

## **VII. Konflikti i interesit**

Këshilltari ligjor duhet të angazhohet, gjatë gjithë misionit, të sigurojë këshilla profesionale, objektive dhe të paanshme dhe të ruajë, në çdo kohë dhe në të gjitha rrethanat, interesat e Republikës së Shqipërisë. Këshilltari ligjor duhet të shmangë situatat e konfliktit të interesit me misionet ose interesat e tjera.

## **VIII. Konfidencialiteti**

Dokumentet dhe të dhënat që do të jenë në dispozicion të ministrisë do të konsiderohen konfidenciale dhe nuk duhet të transmetohen tek palët e treta.

## **IX. Informacion tjetër**

Kjo kërkesë për propozime nuk është një angazhim nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për të pranuar propozime. Ministria e Financave dhe Ekonomisë rezervon të drejtën të pranojë ose të refuzojë çdo dhe të gjitha propozimet, të negociojë modifikimet e propozimeve të paraqitura dhe të heqë dorë nga çdo parregullsi ose informalitet në çdo propozim.

Pasi të zgjidhet finalisti, Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të negociojë një marrëveshje që do të jetë në interesin më të mirë të Republikës së Shqipërisë. Marrëveshja do të përfshijë të gjitha aspektet e propozimit të përshkruar këtu.